



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 2423, datë 27.02. 2014

Për

**“Shqyrtimin e ankimit administrativ të Altelecom sh.a. dhe kërkesat e sipërmarrësve Alban Tirana Nascendo Al sh.p.k dhe Mediatel sh.p.k për ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit të Altelecom, të miratuar me Vendimin nr. 2403, datë 26.12.2013 të AKEP”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj Alketa	Mukavelati	Anëtare
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj.Iris Xhanaj, në mbledhjen e datës 27.02.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”), ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Shqyrtimin e ankimit administrativ të Altelecom sh.a. dhe kërkesat e sipërmarrësve Alban Tirana Nascendo Al sh.p.k dhe Mediatel sh.p.k për ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit të Altelecom, të miratuar me Vendimin nr. 2403, datë 26.12.2013 të AKEP”**

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 8/c, neni 31 e në vijim, neni 52, pika 1 e nenit 114, pika 1 e nenit 115, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (Ligji nr. 9918);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 19 datë 14.06.2010 për “Aksesin dhe Interkoneksionin” miratuar me VKD Nr. 1300, datë 14.06.2010, e ndryshuar. (Rregullorja);

## K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr. 558.Prot., datë 24.1.2014 (nr. 145.Prot. i AKEP, datë 27.1.2013) me anë të së cilës ka paraqitur (1) ankim administrativ ndaj Vendimit nr. 2403, datë 26.12.2013 për “Miratimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit, te përditësuar, te sipërmarrësit Albtelecom sh.a”. (2) Kërkesë për korrigjim akti administrativ të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 2403, datë 26.12.2013.
2. Shkresat e sipërmarrësi Alban Tirana Nascendo Al sh.p.k me nr. 2 prot., datë 07.01.2014, dhe me nr.3 prot. datë 27.01.2014;
3. Shkresa e sipërmarrësit MEDIA-Tel Sh.p.k me nr. 166 prot, datë 28.01.2014;
4. Shkresa e sipërmarrësit Albtelecom Sh.a me nr. 269/1 prot, datë 22.01.2014;
5. Vendimi nr. 2403, datë 26.12.2013 për “Miratimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit, te përditësuar, te sipërmarrësit Albtelecom sh.a”.
6. Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);  
si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

### V Ë R E N :

1. Albtelecom me anë të këtij ankimi të depozituar me me anë të shkresës nr. 558.Prot., datë 24.1.2014 ka paraqitur (1) ankim administrativ ndaj Vendimit nr. 2403, datë 26.12.2013 për “Miratimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit, te përditësuar, te sipërmarrësit Albtelecom sh.a”. (2) Kërkesë për korrigjim akti administrativ të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 2403, datë 26.12.2013.
2. Albtelecom paraqet argumentet për ndryshim/modifikim të Vendimit nr. 2403, datë 26.12.2013, si më poshtë:
  - a. Objekti i kërkesës për modifikimin e këtij vendimi të AKEP lidhet me mospranimin nga AKEP të përditësimit të Ofertës Reference të Interkoneksionit (RIO) nga ana e Albtelecom sh.a, për ofrimin e Pikave Rajonale të Interkoneksionit vetëm për terminim të trafikut drejt përdoruesve të Albtelecom të rajonit përkatës të numeracionit, dhe për pasojë, të paqartësisë në lidhje me aplikimin e shërbimit të mbartjes se thirrjeve.
  - b. Albtelecom shpjegon se ka informuar rregullisht AKEP mbi projektet dhe investimet e kryera që prej vitit 2009 me qëllim kalimin në rrjetin NGN, kalim i cili është finalizuar në muajt e parë të vitit 2013. Albtelecom ka informuar gjithashtu AKEP edhe për efektet që passjell kalimi në këtë teknologji rrjeti dhe në interkoneksionin me operatorët dhe mundësi që ofron kjo teknologji e re rrjeti për të ofruar interkoneksion operatorëve përfitues vetëm ne segment kombëtar. Arkitektura e re e rrjetit Albtelecom dhe kalimi ne NGN është pranuar dhe komentuar edhe nga vetë AKEP në dokumentet rregullatore.

- c. Albtelecom shpjegon se në rrethanat ku centralet TDM në zonat Rajonale dhe Lokale janë hequr nga funksionimi, ofrimi i Pikave të Interkoneksionit në Rajone nuk mund të ketë kuptim dhe të bashkëekzistojë si koncept me rrjetin NGN. Albtelecom ka kërkuar edhe më parë përditësimin e RIO-s për reduktimin e Pikave Rajonale të Interkoneksionit dhe ofrimin të vetëm 2 Pikave Interkoneksioni (ref: shkresa nr.1759, dt. 10.04.2013), por AKEP ka cmuar mospranimin e këtyre ndryshimeve duke e kushtëzuar me respektimin e një grafiku kohor të përshtatshëm për njoftimin e operatorëve si palë të afektuara, njoftim i cili bazuar në të gjitha korrespondencat zyrtare me AKEP është udhëzuar të kryhet pas procesit të vendimarrjes së AKEP mbi RIO-n e Albtelecom dhe në të njëjtën kohë duke u kushtëzuar edhe nga diskutimet e kohës mbi ndryshimet në Planin e Numeracionit dhe Analizën e Tregut të telefonisë fikse të lidhura këto edhe me diskutimet për kalimin e një segmenti të vetëm, për të cilën Albtelecom ka shprehur qëndrimin për shtyrjen e këtij diskutimi në një kohë të mëvonshme.
- d. Pamundësia e centraleve rajonale të interkoneksionit të Albtelecom për të kryer funksionet reale të interkoneksionit dhe në teknologjinë e rrjetit TDM, ka qenë një fakt i mirënjohur dhe pranuar nga AKEP që prej RIO-s së miratuar në vitin 2009 e në vazhdim. Të gjitha shërbimet dhe funksionet e interkoneksionit janë kryer që prej vitit 2008 në centrale tranzite Tiranë dhe Durrës dhe Pikat e Interkoneksionit nëpër Rajone apo edhe në Zona Lokale kanë shërbyer vetëm si Pika demarkacioni gjeografike (Pika virtuale) ku është ofruar interkoneksioni me rrjetin Albtelecom. Në kushte të tilla dhe nën detyrimet rregullatore të përcaktuara nga AKEP për ofrimin e Pikave Rajonale dhe lokale të Interkoneksionit, Albtelecom ka pranuar të përballojë kostot për transportimin e trafikut nga dhe drejt këtyre pikave duke e shprehur këtë fakt në mënyrë të shkruar në dokumentet e RIO-ve që prej vitit 2008.
- e. Në vijim të Vendimit nr.2337 dt. 30.07.2013 për shpallje me FNT të Albtelecom në tregjet e telefonisë fikse dhe detyrimin ligjor për përditësimin e RIO-s, si dhe miratimin përfundimtar të Analizës së tregut të Telefonisë Fikse dhe miratimit të Ndryshimeve të Planit Kombëtar të Numeracionit, Albtelecom dërgoi pranë AKEP dokumentin e përditësuar të RIO-s në Nëntor të vitit 2013. Përditësimi i këtij dokumenti ka konsistuar kryesisht në reflektimin e ndryshimeve rregullatore të përcaktuara nga Dokumentet Rregullator të referuar më lart si dhe reflektimet e domosdoshme të ndryshimeve në termat e ofrimin të interkoneksionit me rrjetin Albtelecom në kushtet e rrjetit NGN.
- f. Në referencë të gjithë korrespondencave të deritanishme me AKEP dhe argumentimeve përkatëse në akte rregullatore në lidhje me këto çështje dhe shqetësimeve të AKEP në lidhje me impaktet në treg. Albtelecom ka bërë përditësimin e RIO-s duke pranuar qasjen e AKEP për ofrimin e Interkoneksionit në 12 Pika Rajonale por duke specifikuar në të njëjtën kohë se këto Pika do të shërbejnë si referencë për shërbimet e trafikut brenda Rajonit përkatës (AO/AT), duke përballuar në të njëjtën kohë edhe kostot për transportin e trafikut nga/drejt Pikave nëpërmjet centraleve softseich në Tiranë dhe Durrës.
- g. Por, për sa parashtruam në të gjithë dokumentin më lart, dhe nën konceptin e rrjetit NGN dhe kësaj topologjie të rrjetit, Albtelecom nuk mundet të vazhdojë të pranojë të sanksionuar në dokumentin e RIO-s sapo miratuar, se Pika Rajonale shërben edhe për terminim dhe tranzitim të thirrjeve drejt gjithë përdoruesve të rrjetit Albtelecom aq më tepër të vazhdojë të përballojë kostot për transportimin e trafikut edhe nën këtë detyrim si për origjinin ashtu edhe terminim nga pikat e interkoneksionit ku kërkohet të bëhet lidhja nga operatorët e tjerë deri në centralet tranzite, kështu që në kuptim të

Ligjit për Komunikimet Elektronike, në kërkesat e RIO-s që i është paraqitur AKEP, Albtelecom ka menduar se ky detyrim është jo proporcional dhe përbën barrë të rëndë për operatorin, ndaj Albtelecom kërkoi të paktën të ruajë të drejtën të rikuperojë një minimum kostosh për mbartjen e trafikut për terminim dhe tranzitim drejt gjithë rrjetit Albtelecom.

- h. Gjithashtu në dokumentin e miratuar të RIO-s, nuk kuptohet në mënyrë të qartë nëse Albtelecom do të mund të aplikojë shërbimin e bartjes së thirrjeve, përcaktimet e të cilit janë hequr nga Aneksi përkatës i përshkrimit të Interkoneksionit me Albtelecom (Aneks 2, pika 2, paragrafi vijues pas nënpikës 2.2), por këto përcaktime kanë mbetur të pamodifikuara në Aneksin përkatës të shërbimeve të Albtelecom (Aneks 3, pika 1,2,4), në Aneksin e Tarifave (Aneks 4, pika 1.1.2.1/3 dhe në Aneksin e Cështjeve Teknike, (seksioni i Rugëzimit të Trafikut, Aneks 6, pika 8, paragrafi i fundit). Kështu Albtelecom do të vlerësojë sqarimin nga ana Juaj mbi qëndrimin përfundimtar të AKEP në lidhje me aplikimin e këtij shërbimi dhe afatin kohor prej kur Albtelecom i lind e drejta për të filluar tarifimin e këtij shërbimi.
- i. Albtelecom beson se të gjithë operatorët janë të mirëinformuar mbi kalimin e Albtelecom në rrjetin NGN, ashtu sikurse janë tashmë të mirëinformuar mbi impaktet dhe iniciativat e diskutimet e zyrtarizuara në dokumente rregullator për kalimin gradualisht drejt një segmenti të vetëm qoftë në interkoneksion qoftë edhe në aplikimin e tarifave për përdoruesit fundorë.
- j. Në këto rrethana, dhe duke iu referuar edhe qëndrimeve të AKEP dhënë në shkresat nr.710/1 dt 19.04.2013 dhe Vendimeve nr.2325 dt 28.06.2013 dhe VKD nr.2344 dt 30.08.2013 dhe në zbatim të Nenit 146 germa b) e Kodit të Procedurave Administrative, Albtelecom i kërkon AKEP:

- 1. Modifikimin e aktit administrativ Vendimit të AKEP Nr.2403 dt.26.12.2013 Per *“Miratimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit, të përditësuar, të sipërmsarresit Albtelecom sh.a”*. dhe pranimin e ankimit të aktit administrativ, përkatësisht në lidhje me, lënien në fuqi të përcaktimeve më poshtë sipas dokumentit të RIO dërguar në AKEP me shkresën nr. 7316 dt. 15.11.2013.

**a) Aneks 2 “Interkoneksioni me Rrjetin Albtelecom” pika 2.2;**

***Pikë interkoneksioni rajonale që ndodhet (apo lidhet me) në central gateëay të aksesit për zonat rajonale të interkoneksionit të Albtelecom dhe shërbimin për interkoneksion në rrjetin Albtelecom për terminimin e thirrjeve të origjinuara nga pajtimtarët e operatorëve të rrjeteve publike të telefonisë të autorizuar në Republikën e Shqipërisë, drejt përdoruesve të rrjetit Albtelecom të rajonit përkatës të numeracionit.***

*Albtelecom ofron shërbimet e interkoneksionit për terminim dhe tranzitimin e thirrjeve kombëtare në të gjithë rrjetin Albtelecom në Pikën e Interkoneksionit kombëtar nëpërmjet centraleve gateëay e aksesit në zonën kombëtare të interkoneksionit Tiranë dhe/ose Durrës. Operatorët mund të zgjedhin të interkonektojnë rrjetin e tyre në këto Pika Kombëtare Interkoneksioni ose të marrin prej Albtelecom shërbimin e bartjes së thirrjeve nga Pika e Interkoneksionit me Operatorët Përfitues drejt centraleve gateëay të aksesit Durrës dhe/ose Tiranë sipas përcaktimeve në Aneks 2 “Përshkrimi i Shërbimeve” dhe Aneks 3 “Tarifat e Shërbimeve”.*

2. Albtelecom do të vlerësonte sqarimin nga AKEP mbi qëndrimin përfundimtar të tij në lidhje me aplikimin e shërbimit të bartjes së thirrjes dhe afatin kohor prej kur Albtelecom i lind e drejta për të filluar tarifimin e këtij shërbimi.
3. Në të njëjtën kohë Albtelecom kërkon edhe korrigjim të aktit administrativ të miratuar me vendimin nr.2325 në përputhje me dokumentin e RIO-s së përditësuar të dërguar me shkresën nr.1759 dt. 10.04.2013 në lidhje me saktësimin e një sërë elementësh në funksion të evitimit të cdo keqkuptimi të mundshëm që mund të rezultojë nga keqinterpretimi që mund t'i bëhet dokumentit në përcaktime të vecanta të tij, si më poshtë vijon:

**1.Në Aneks 1“Përkufizime” definicioni “Pika fundore e rrjetit të mbetet si më poshtë:**

<b>Pika fundore e rrjetit:</b>	është pika fizike në të cilën një pajtimtar ka Akses në rrjetin e komunikimeve publike. Në rastin e rrjeteve, që përfshijnë komutimin ose rrugëzimin pika fundore e rrjetit identifikohet si një adresë specifike e rrjetit, e cila mund të lidhet me numrin ose emrin e një pajtimtari.
--------------------------------	--

**2. Në Aneks 4 “Tarifat e Shërbimeve”, pika 1.1.1.2 në paragrafin e fundit me gërma italic mbeten fjalët “rrjeti tjetër” si dhe në pikën 1.1.2.1/1 mbeten fjalët “dhe terminim kombëtar” si më poshtë:**

*Albtelecom aplikon transaksionin financiar 2% të vlerës së detyrimit të mbartur të trafikut të tranzituar drejt një operatori/rrjeti tjetër, e cila paguhet nga operatori që dorëzon trafikun për tranzitim.*

**1.1.2.2/1 Tarifimi i Shërbimi i përcaktimit të kodit të rrugëzimit për rrugëzimin e thirrjeve kombëtare drejt operatorëve Mobile në Procesin e Portabilitetit të Numrit.**

Në rastin kur operatori përkates ka arritur marrëveshje me Albtelecom sh.a. për pranimin e thirrjeve të origjinuara nga pajtimtarët e tij, pa kodin përkatës të rrugëzimit, shërbim, i analizimit të thirrjeve (all-call-query) dhe përcaktimi i kodit përkatës të rrugëzimit do të tarifohej për cdo thirrje të analizuar, për shërbimin e tranzitimit dhe terminimit kombëtar në Aneks 4 “Tarifat e Shërbimeve” Seksioni 1.1.2.1.

3. Në Aneks 4 “Tarifat e shërbimeve” pika 1.1.4. “Shërbimi i Origjinimit nga Albtelecom” të korigjohet tabela në versionin e publikuar të RIO-s sipas tabelës së mëposhtëme:

<b>Shërbimi Trafiku Origjinim</b> Sipas pikës 1.1.4	<b>01.01.2014- 31.08.2014</b>	<b>01.09.2014-deri në një Vendim tjetër të AKEP</b>
Segment Rajonal	1.34 lekë/min	1.19 lekë/min

Segment Kombëtar	2.68 lekë/min	1.85 lekë/min
Tarifë për thirrje të sukseshme	0.53 leke	0.38 lekë

**4. Në Aneks 4 “Cështje Teknike”, pika 8 “Rrugëzimi i trafikut” në paragrafin e dytë të mbetet togfjalëshi “apo rrjeteve të tjerë” si më poshtë:**

Në pikat e interkoneksionit rajonale do të pranohet vetëm trafik i origjinuar nga pajtimtarët e operatorit përfitues i destinuar për pajtimtarët e Albtelecom apo rrjeteve të tjerë që i korrespondojnë zonën rajonale përkatëse. Numërformimi për trafikun e shkëmbyer në zonën rajonale do të jetë formati NDC+SN i palës së thirrur.

3. Sipërmarrësi Alban Tirana Nascendo Al ka depozituar në AKEP shkresën me nr. 2 prot. datë 07.01.2014, (nr. 17 Prot. datë 07.01.2014 i AKEP) “Kërkesë për rishikimin e Aneksit 5 të Ofertes Reference të Interkoneksionit e Albtelecom Sh.a për Operatorët e Rrjeteve të Komunikimeve Elektronike OSHKP – THK, e miratuar nga AKEP me VKD Nr.2403, datë 26.12.2013”. Sipërmarrësi Alban Tirana Nascendo Al, në kërkesën tij paraqet problematikën si vijon:
  - a. Si Operator i shërbimit telefonik me kartë të parapaguar ndjehet i diskriminuar nga Aneksi 5 i RIO Albtelecom Sh.a, i miratuar nga AKEP me VKD Nr.2403, datë 26.12.2013. Ky aneks rikthen dhe një herë në vëmendje problemin me tarifën dhe terminimin dhe origjinimin thirrjeve, ku AKEP me VKD Nr. 2068, datë 14.06.2012 (Vendim Organik) ka imponuar rregullimin e tarifave përkatëse në RIO Albtelecom, vendim i cili ka rregulluar mardhenjet ekonomike midis Sipërmarrësit Alban Tirana Nascendo Al dhe Albtelecom Sh.a.
  - b. Në Aneksin 5 të RIO-s Albtelecom Sh.a, sipërmarrësi Alban Tirana Nascendo Al thekson se thirrjet telefonike me kartë të parapaguar për operatorët SHKP – THK janë të terminuara dhe origjinuara në segmentin kombëtar me tarifën përkatëse 2.68 lekë/min për terminimin dhe 0.53 lekë/min për origjinimin e thirrjeve telefonike, dhe është eliminuar Segmenti Rajonal dhe tarifën përkatëse. Kjo bisedë me VKD nr. 2336, datë 30.07.2013. ku është percaktuara qartë ndarja e segmenteve në piken 3.5, tabelën 1 të këtij vendimi.
  - c. Sipërmarrësi Alban Tirana Nascendo Al duke marrë parasysh Vendimet e mëparshme të AKEP, përkatësisht VKD nr. 2068, datë 14.06.2012 që rekomandon ndarjen e origjinimit, terminimit të thirrjeve telefonike në zonë rajonale dhe zonë kombëtare, bazuar në studimin e tregut të telefonisë fikse me VKD NR. 2337, datë 30.07.2013, kërkon që AKEP të bëjë ndërhyrje për të rregulluar në RIO të Albtelecom, aneksi 5, tarifën në zonë lokale dhe zonë kombëtare.
  - d. Sipërmarrësi Alban Tirana Nascendo Al i drejtohet AKEP duke riperseritur se aneksi 5 i RIO Albtelecom është diskriminues dhe në kundërshtim me Vendimin KD Nr. 2068 datë 14.06.2012, Vendimin KD Nr 2337 datë 30.07.2013 të AKEP. Alban Tirana Nascendo Al thekson se aneksi 5 i RIO Albtelecom është në kundërshtim me Ligjin 9918, datë 19.05.2008, Neni 53, pika 1. “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë. Në shkresë e cituar më lartë Alban Tirana Nascendo Al kërkon fillimin e procedimit administrativ me qëllim zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje.

4. Sipërmarrësi Albtelecom Sh.a me shkresën nr. 269/1 prot, datë 22.01.2014 “ Përgjigje e shkresës së AKEP nr.15/1 datë 13.01.2014 mbi dhënie qëndrimi për kërkesën e Sipërmarrësi Alban Tirana Nascendo Al sh.p.k“, e protokolluar ne AKEP me nr.15/2 prot, datë 22.01. 2014, argumenton qëndrimin si vijon:
- a. Ndryshimi i bërë ne aneksin 5 të RIO Albtelecom qendron se ofron akses në rrjetin Albtelecom për ofrusit e shërbimit të thirrjes me kartë vetem në pikën e aksesit MGW2 Tr Tiranë. Në konceptin e këtij shërbimi dhe aksesit të ofruar në rrjet, ofrimi i shërbimit të origjinimit dhe terminimit të thirrjes mundësohet vetem në segmentin kombëtar qe në këtë rastë është segmenti dyfish.
  - b. Pretendimi i Alban Tirana Nascendo Al sh.p.k se aneksi 5 është në kundërshtim me VKD Nr.2337 e konkretisht ne pikën 3.5 është i pabazë. Në aneksin 5, pika 3.5, të RIO jepen tarifatat e shërbimeve të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit të thirrjeve dhe shërbimeve të interkoneksionit të lidhura me këto shërbime në rrjetin publik telefonik fiks të Albtelecom, ndërkohë ne aneksin 5 jepen tarifatat e interkoneksionit për një shërbim jo-gjeografik, pra një shërbim i nje natyre tjetër i cilli rrjedhimisht ka nje rregullim tjetër.
  - c. Albtelecom thekson se përdorimi i këtyre kartave bëhet ne distancë të largët dhe jo lokalisht. Lejimi i përdorimit të këtyre kartave për thirrje lokale nuk është në interes të pajtimitarit i cili nuk merrë asnjë përfitim shtesë në cilësi dhe tarifë. Kjo provohet dhe nga trafiku i OSHKP i terminuar në Albtelecom ne segmentin lokal është mjaft i ulët konkretisht rreth 1%.
  - d. Sipas Albtelecom ekziston mundësia e shfaqjes fenomenit të thirrjeve call back ndërmjet dy platformave të kartave, dhe terminimit e thirrjeve nderkombetare si thirrje lokale. Albtelecom shpjegon se këto karta përmbajnë informacionin e nevojshem i cili mund të dërgohet nëpërmjet të një kodi (USSD Code) që formohet nga pajtimitari Albtelecom dhe platforma merr sinjalizim për kryerjen e një thirrje dalëse nderkombëtare, abonenti e shkëput komunikimin në këtë fazë dhe nuk kryen thirrjen deri në fund. Në këtë rast sipas Albtelecom, Operatorët OSHKP terminojnë lokalisht thirrje nderkombëtare në rrjetin Albtelecom dhe Albtelecom duhet të tarifojë si trafik lokal thirrjet që nuk janë të tilla.
5. Sipërmarrësi Alban Tirana Nascendo Al me shkresën nr.3 prot. datë 27.01.2014, “Kërkesë për fillimin e procedimit administrativ me qëllim anulimin /rishikimin e aksesit 5 të RIO-s Albtelecom Sh.a për Operatorët e rrjeteve të komunikimeve publike, VKD Nr.2403, datë 26.12.2013”, kërkon përsëri rishikimin e tarifave të origjinimit për OSHKP.
6. Sipërmarrësi MEDIA-Tel Sh.p.k ka depozituar në AKEP shkresën me nr. 166 prot, datë 28.01.2014 “ Kërkesë për fillimin e procedimit administrativ për rishikimin/anulimin e aksesit 5 të RIO Albtelecom e miratuar nga AKEP me VKD Nr.2403, datë 26.12.2013”. Ky sipërmarrës ka kërkesë të njëjtë me Alban Tirana Nascendo, duke kërkuar që AKEP të ndërhyjë në aneksin 5 të RIO-s Albtelecom duke bërë rregullimin përkatës me qëllim ndërprejen e diskriminimit nga Albtelecom si dhe zgjidhjen përfundimisht të mosmarrëveshjes me Albtelecom të të gjithë Operatorve me kartë të parapaguar.
7. AKEP lidhur me kërkesat e Albtelecom sh.a në lidhje me RIO, të parashtruara në pikën 2 më sipër, gjykon se:
- a. Cështja e pikave të interkoneksionit rajonale dhe trafikut të lejuar në këto pika është diskutuar disa herë dhe AKEP ka marrë në konsideratë ndryshimet e rrjetit Albtelecom, si dhe ka propozuar nisjen e diskutimeve me operatorët e tjerë për efektet e ndryshimeve të rrjetit në interkoneksionin me këta operatorë. Pra AKEP nuk gjykon të ndryshojë qëndrim në lidhje me përcjelljen në 12 pikat rajonale edhe të trafikut drejt destinacioneve jashtë zonës rajonale përkatëse, pra të mos pranojë propozimin e

- Albtelecom (pika 2/j/1 më sipër) për revokimin e ndryshimeve të imponuara nga AKEP në lidhje me këtë çështje. Çështja e afatit të kalimit në një segment terminimi/origjinimi, efektet e NGN në interkoneksion apo se kur Albtelecom mund të tarifojë për bartjen e trafikut nga pikat rajonale drejt pikave kombëtare të interkoneksionit do të jenë objekt diskutimi midis AKEP, Albtelecom dhe operatorët e tjerë të interkonektuar me Albtelecom, dhe vendim-marrjes përkatëse të AKEP. AKEP angazhohet që këto diskutime të zhvillohen brenda vitit 2014 dhe mundësisht edhe vendim-marrja të kryhet brenda vitit 2014. Faktor i rëndësishëm për këto procese do të jetë bashkëpunimi i Albtelecom dhe operatorëve të tjerë.
- b. Në lidhje me komentin e cituar në pikën 2/h më sipër për paqartësi në dokumentin e RIO për shërbimin e bartjes së thirrjeve midis pikave rajonale dhe kombëtare të interkoneksionit, AKEP gjykon se kërkesa është e drejtë dhe ndryshimet e imponuar nga AKEP në miratimin e RIO më 26.12.2013, duhet të reflektohen edhe në pjesët e tjera të RIO të cituara nga Albtelecom.
  - c. Kërkesa e Albtelecom për saktësime në tekstin e RIO, referuar në pikën 2/j/3 më sipër është e arsyeshme dhe në RIO duhet të kryhen ndryshimet e propozuara nga Albtelecom, në Aneks 1 dhe Aneks 4 të RIO.
8. AKEP pas shqyrtimit të kërkesës së dy operatorve të kartave me parapagim (OSHKP), dhe përgjigjes së Albtelecom për pretendimet e Alban Tirana Nascendo Al gjykon se në vijim të Vendimit 2337, datë 30.07.2013 (i cili redukton segmentet e terminimit/origjinimit nga 3 në 2, duke bashkuar segmentin lokal dhe rajonal), dhe bazuar në Vendimin nr. 2068, datë 14.06.2012 i cili ka vendosur që Albtelecom të aplikojë tre segmente terminimi/origjinimi për OSHKP, në varësi të pikave të interkoneksionit midis palëve, RIO e Albtelecom duhet normalisht të përmbante për OSHKP dy segmente origjinimi/terminimi si edhe për operatorët e rrjeteve fikse. AKEP në Vendimin nr. 2068, datë 14.06.2012 ka arsyetuar se lidhja midis Albtelecom dhe OSHKP-ve është e ngjashme me lidhjen me operatorët e rrjeteve dhe se shërbimi i ofruar nga OSHKP i shërben rritjes së mëtejshme të konkurrencës për thirrje telefonike dhe alternativave të konsumatorëve për të kryer thirrje telefonike. Megjithatë, krahas ngjashmërive në lidhjen e OSHKP-ve me Albtelecom me operatorët e rrjeteve, midis dy grupeve ka ndryshime. OSHKP janë ofrues shërbimi që hostohen në rrjetin e një operatori dhe aksesit në shërbimet e tyre kryhet nëpërmjet numrave jo-gjeografikë 0801xxxx. Operatorët e rrjeteve fikse mund të kenë disa pika interkoneksioni për të shfrytëzuar terminim/origjinim dhe në nivele më të ulëta si lokal/njëfish, pasi kjo i krijon mundësinë e konkurrencës me operatorin incumbent në ofrimin e thirrjeve lokale/rajonale për pajtimtarët. Pra përdorimi/tarifimi i shërbimeve të interkoneksionit në nivele lokale apo rajonale shërben për komunikim midis pajtimtarëve të dy rrjeteve brenda së njëjtës zonë lokale apo rajonale. Ndërkohë OSHKP aktualisht kanë vetëm një pikë lidhje aksesit në rrjetin Albtelecom dhe duke qenë se për këtë akses përdoret një numër jo-gjeografik 0801xxxx, nuk ka kuptim që një ofrues shërbimi i tillë të ketë më shumë se një pikë lidhjeje. Gjithashtu OSHKP përdorin origjinimin e thirrjeve kryesisht për thirrje ndërkombëtare (vetëm 1% e thirrjeve janë kombëtare), si dhe trafiku i origjinuar për OSHKP ka shpërndarje afërsisht të barabartë midis segmentit lokal dhe dyfish, d.m.th me një kosto mesatare afërsisht 2.5 lek/minutë  $[(1.5+3.5)/2]$  dhe 0.83 leke për thirrje deri para ndryshimit të tarifave më 1.01.2014. Me ndryshimin e tarifave më 1.01.2014, Albtelecom në RIO ka përfshirë vetëm një segment, segmentin dyfish me 2.68 lek/minutë dhe 0.53 lek/thirrje. Pra në terma të përfitimeve shtesë nga reduktimi i tarifave të origjinimit/terminimit më 1.01.2014 OSHKP janë në nivel pothuajse të njëjtë me nivelin e mëparshëm të tarifave. Bazuar në sa më sipër AKEP



gjykon që për OSHKP tarifimi i origjinimit/terminimit të jetë me një nivel. Duke qenë se shërbimi i origjinimit është shërbimi bazë për OSHKP pasi thirrjet janë kryesisht ndërkombëtare, për origjinimin të aplikohet tarifa mesatare midis dy segmenteve rajonal/kombëtar. Ndërsa për terminimin të aplikohet një tarifë ajo e segmentit dyfish. Ky lloj tarifimi duhet të implementohet duke filluar nga data 1 Mars 2014 dhe të vazhdojë edhe në fazën e dytë të reduktimit të tarifave me të njëjtën formulë duke aplikuar vlerat e reja të tarifave të origjinimit/terminimit. Këto ndryshime cojnë në rritje të përfitimeve dhe aftësisë konkurruese të OSHKP nga reduktimi i tarifave të origjinimit/terminimit në rrjetin Albtelecom, pa qenë nevoja për lidhje jo të nevojshme në më shumë se një pikë aksesit në rrjetin Albtelecom, dhe njëkohësisht në një mjedis më konkurrues për thirrje telefonike nga rrjete fikse. Në kushtet aktuale të mënyrës së tarifimit të thirrjeve në nivel me pakicë dhe migrimi i plotë në rrjetin NGN nga Albtelecom, kalimi me një nivel tarifimi i shërbimeve të terminimit/origjinimit parashikohet të kryhet edhe për operatorët e rrjeteve fikse, brenda një periudhe afatshkurtër deri afatmesme, sic është cituar edhe më lart nga AKEP.

9. Për sa më sipër, AKEP gjykon të marrë në konsideratë disa prej kërkesave të Albtelecom dhe operatorëve të kartave me parapagim për ndryshime në RIO.

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 146, të K.Pr.A,

## **V E N D O S:**

1. Të pranohet pjesërisht ankimin administrativ të sipërmarrësit Albtelecom sh.a dhe kërkesat e sipërmarrësve Alban Tirana Nascendo Al sh.p.k dhe Media-Tel sh.p.k, për ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit të Albtelecom, të miratuar me Vendimin nr. 2403, datë 26.12.2013 të AKEP".
2. Në dokumentin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit të Albtelecom, të miratuar nga AKEP me VKD nr.2403, datë 26.12.2013, të kryhen ndryshimet e mëposhtëme:
  - a. Në Aneks 1, "Përkufizime", termi "Pika fundore e rrjetit" të ndryshohet si më poshtë:  
*Pika Fundore e Rrjetit është pika fizike, në të cilën një pajtimtar ka akses në rrjetin e komunikimeve publike. Në rastin e rrjeteve, që përfshijnë komutimin ose rrugëzimin pika fundore e rrjetit identifikohet si një adresë specifike e rrjetit, e cila mund të lidhet me numrin ose emrin e një pajtimtari*
  - b. Në Aneks 3, të hiqet paragrafi në pikën I.1.2.4
  - c. Në Aneks 4,

### **1.paragrafi aktual në pikën I.1.2.1:**

*Albtelecom aplikon transaksionin financiar 2% të vlerës së detyrimit të mbartur të trafikut të transituar drejt një operatori, e cila paguhet nga operatori që dorëzon trafikun per tranzitim.*

**Të zëvendësohet me:**

*Albtelecom aplikon transaksionin financiar 2% të vlerës së detyrimit të mbartur të trafikut të transituar drejt një operatori/**rrjeti tjetër**, e cila paguhet nga operatori që dorëzon trafikun per tranzitim.*

**2.paragrafi aktual ne pikën I.1.2.1/1:**

*Në rastin kur operatori përkatës ka arritur marrëveshje me Albtelecom Sh.a për pranimin thirrjeve të origjinuara nga pajtimtarët e tij, pa kodin përkatës të rrugëzimit, shërbimi i analizimit të thirrjeve (all-call-query) dhe përcaktimi i kodit përkatës të rrugëzimit (database look-up) do të tarifohen krahas tarifës së tranzitimit dhëne në Aneks 4 “Tarifat e Sherbimeve” Seksioni I.1.2.1. Tarifat e këtij shërbimi përcaktohen komercialisht mes palëve.*

**Të zëvendësohet me:**

*Në rastin kur operatori përkatës ka arritur marrëveshje me Albtelecom Sh.a për pranimin thirrjeve të origjinuara nga pajtimtarët e tij, pa kodin përkatës të rrugëzimit, shërbimi i analizimit të thirrjeve (all-call-query) dhe përcaktimi i kodit përkatës të rrugëzimit (database look-up) do të tarifohen krahas tarifës së tranzitimit dhe **terminimit kombëtar** dhëne në Aneks 4 “Tarifat e Sherbimeve” Seksioni I.1.2.1.*

**3.**Tabela aktuale në pikën I.1.4 që përmban tarifat e “Shërbimit të origjinimit në rrjetin Albtelecom” të zëvendësohet me tabelën e mëposhtëme:

<b>Sherbimi Trafikut Origjinim sipas pikes I.1.4</b>	<b>01.01.2014 – 31.08.2014</b>	<b>01.09.2014 – deri në një Vendim tjetër të AKEP</b>
Segment Rajonal	1.34 lekë/min	1.19 lekë/min
Segment Kombëtar	2.68 lekë/min	1.85 lekë/min
Tarifë për thirrje të suksesshme	0.53 lekë	0.38 lekë

d. Në Aneks 4 të hiqet paragrafi **I.1.2.1/3**

e. Në aneks 5

**1.Paragrafi dhe tabela aktuale:**

*Detyrimi i OSHTHK ndaj Albtelecom për origjinimin e thirrjeve përcaktohet sipas segmentit të origjinimit në segment kombëtar të thirrjeve drejt kodit të aksesit OSHTHK sipas vlerave të dhëna në tabelen e mëposhteme:*

<b>Sherbimi Trafikut Origjinim</b>	<b>01.01.2014 – 31.08.2014</b>	<b>01.09.2014 – deri në një Vendim tjetër të AKEP</b>
Origjinim kombëtar	2.68 lekë/min	1.85 lekë/min
Tarifë për thirrje të suksesshme	0.53 lekë	0.38 lekë

**Të zëvendësohet me:**

*Detyrimi i OSHKP ndaj Albtelecom për origjinimin e thirrjeve përcaktohet sipas segmentit përkatës të origjinimit të thirrjeve drejt kodit të aksesit OSHKP, sipas vlerave të dhëna në tabelen e mëposhteme:*

<b>Sherbimi Trafikut Origjinim OSHKP</b>	<b>01.03.2014 – 31.08.2014</b>	<b>01.09.2014 – deri në një Vendim tjetër të AKEP</b>
Origjinim OSHKP	2.01 lekë/min	1.52 lekë/min
Tarifë për thirrje të suksesshme	0.53 lekë	0.38 lekë

## **2.Tabela aktuale e mëposhtëme**

Për thirrjet që rrugëzohen nga OSHTHK në rrjetin Albtelecom për terminim në rrjetin Albtelecom, tarifa e terminimit përcaktohet sipas segmentit dyfish sipas vlerave të dhëna në <b>Sherbimi Trafikut Terminim</b>	<b>01.01.2014 – 31.08.2014</b>	<b>01.09.2014 – deri në një Vendim tjetër të AKEP</b>
Terminim kombëtar	2.68 lekë/min	1.85 lekë/min
Tarifë për thirrje të suksesshme	0.53 lekë	0.38 lekë

### **Të zëvendësohet me:**

*Për thirrjet që rrugëzohen nga OSHKP në rrjetin Albtelecom për terminim në rrjetin Albtelecom, tarifa e terminimit përcaktohet sipas segmentit përkatës sipas vlerave të dhëna në tabelën e mëposhtëme*

<b>Sherbimi Trafikut Terminim OSHKP</b>	<b>01.01.2014 – 31.08.2014</b>	<b>01.09.2014 – deri në një Vendim tjetër të AKEP</b>
Segment Kombëtar	2.68 lekë/min	1.85 lekë/min
Tarifë për thirrje të suksesshme	0.53 lekë	0.38 lekë

f. Në Aneks 6,

### **paragrafi aktual në pikën 8:**

*Albtelecom ofron shërbimet e interkoneksionit për terminim dhe tranzitim të thirrjeve kombëtare në të gjithë rrjetin Albtelecom në Pikën e Interkoneksionit kombëtare nëpërmjet centraleve gateëay të aksesit në zonën kombëtare të interkoneksionit Tiranë dhe/ose Durrës. Operatorët mund të zgjedhin të interkonektojnë rrjetin e tyre në këto Pika Kombëtare Interkoneksioni ose të marrin*

*prej Albtelecom shërbimin e bartjes së thirrjeve nga Pika e Interkoneksionit me Operatorin Përfitues drejt centraleve gateëay të aksesit Durrës dhe/ose Tiranë sipas përcaktimeve në Aneks 2 “Përshkrimi i Shërbimeve” dhe Aneks 3 “Tarifat e Shërbimeve*

**Të zëvendësohet me:**

*Albtelecom ofron shërbimet e interkoneksionit për terminim dhe tranzitimin e thirrjeve kombëtarë në të gjithë rrjetin Albtelecom në Pikën e Interkoneksionit kombëtare nëpërmjet centraleve gateëay të aksesit në zonën kombëtare të interkoneksionit Tiranë dhe/ose Durrës dhe në secilën prej pikave rajoale të interkoneksionit.*

3. Të gjitha efektet e ndryshimeve të miratuara me këtë vendim, hyjnë në fuqi duke filluar nga data e miratimit të këtij vendimi. Tarifat e përcaktuara në pikën 2/e/1 më sipër hyjnë në fuqi më 1.03.2014.
4. Të njoftohen Albtelecom sh.a. për zbatimin e këtij Vendimi;
5. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R**

**PIRO XHIXHO**

**ANËTARË:**

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Alketa MUKAVELATI**
- 3. Benon PALOKA**
- 4. Zamira NURÇE**